



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Buletini Nr. 3



Mbështetje për
Organizatat e Shoqërisë
Civile
për të zhvilluar
Ndërmarrje
Sociale

MBESHTETJA PER NDERMARRJET SOCIALE

PERMBAJTJA

30 ORGANIZATA TE SHOQERISE CIVILE PO KRIJOJNE NDERMARRJE SOCIALE NE SHQIPERI

Projekti “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale” është në fund të vitit të dytë të zbatimit dhe aktualisht në rreth 4-5 muajt e fundit është duke menaxhuar grantet e vena në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve).

Nga fondi prej 77,600 Euro kanë përfituar 30 organizata, të cilat janë duke zbatuar idenë e tyre të biznesit social, i cili ka për qëllim krijimin e një veprimtarie ekonomike duke ruajtur fokusin social të tyre.

Në shpërndarjen e grantit, projekti arriti të realizonte synimet e tij ku përfituese të ishin veçanërisht ato organizata të cilat kanë më pak shanse për të aksesuar në përfitimin e granteve edhe projekteve, janë më larg kryeqytetit, organizata lokale që punojnë pranë komuniteteve, etj.

Kështu projekti arriti që të siguronte një shpërndarje të grantit tek organizata të cilat janë me vendndodhje në zona të ndryshme të Shqipërisë, pra duke realizuar kriterin e shpërndarjes sa më të gjërë gjeografike. Aktualisht ka një shtrirje

prej 10 rajonesh të ndryshme si vendndodhje të organizatave apo edhe më tepër si zona të ndërhyrjes së ideve të tyre.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se projekti mbështeti organizata që ishin në vitin e parë të themelimit të tyre apo edhe në fillimin e veprimtarisë së tyre duke shpresuar që ato të ecin më përpara në misionin e tyre me mbështetjen tonë fillestare.

Gjithashtu disa organizata të tjera ndonëse funksiononin prej vitesh kishin disa vite që nuk kishin arritur të përfitonin nga thirrjet për projekte. Edhe këtu shpresojmë që nëpërmjet grantit të kontribuojmë sadopak për të zhvilluar organizatat e vogla që punojnë pranë komuniteteve, por edhe për fuqizimin e modelit të funksionimit si një ndërmarrje sociale.

Po ashtu, projekti mbështeti edhe organizata, të cilat kishin disa vite që plotësonin kushtet dhe kriteret e përcaktuara për të funksionuar si një Ndërmarrje Sociale, duke ju dhënë mundësi për fuqizimin e shërbimeve të tyre në dobi të shtresave të pafavorizuara.

Mbështetja për NS	1
Rekomandime për politikat për NS	2
Mbi vlerësimin e potencialeve për zhvillimin e NS-ve	3
Shpërndarja e granteve	4
Partnët në Projekt	4

[Informacion më të detajuar mbi Projektin do të gjeni në:](#)

[Website dhe Mediat Sociale](#)

<http://www.ccp.al>
<http://www.rdatirana.al>

www.facebook.com/SocialEnterprises-CSOs

www.facebook.com/ccpalbania

“Ky material komunikimi reflekton vetëm pikëpamjet e autorëve dhe Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin e përmbajtjes së këtij informacioni”

“**Dokument Politikash mbi Mjedisin Ligjor të sektorit të NS, gjetjet dhe sfidat**”, një dokument që analizon kuadrin ligjor të Ndërmarrjeve Sociale (NS) në Shqipëri, Disa nga rekomadimet e nxjerra nga ky dokument janë:

Krijimi i një strategjie: «Për zhvillimin e sipërmarrjes sociale» e cila në vetvete duhet të përcaktojë qartë ndërmarrjet sociale si “biznese të bazuara në parimet e qëndrueshmërisë shoqërore, mjedisore dhe ekonomike, ku fitimi / teprica tërësisht riinvestohet për përfitim të komunitetit”. Katër fusha prioritare të politikave për NS duhet të jenë:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i kuadrit legjislativ dhe institucional;
- Krijimi i një kuadri financiar adekuat dhe mbështetës;
- Promovimi i rëndësisë dhe rolit të sipërmarrjes sociale nëpërmjet edukimit formal dhe joformal;
- Rritja e vizibilitetit të ndërmarrjeve sociale në të gjithë vendin

Masat legjislative dhe rregullatore duhet të jenë:

- kryerja e një analize të thellë të nevojave të ndërmarrjeve ekzistuese sociale dhe kuadrit ligjor aktual, për rishikimin dhe harmonizimin e legjislacionit me direktivat e BE-së,
- futja e përfitimeve dhe stimujve për ndërmarrjet sociale;
- -sigurimi i hapësirave publike dhe ndërtesave të papërdorura për përdorim nga ndërmarrjet sociale;
- zhvillimi i partneriteteve midis organeve publike për të mbështetur sipërmarrjen sociale;
- zhvillimi i mbështetjes për hulumtimin cilësor dhe sasior dhe metodologjinë e matjes së ndikimit social.
- vendosja e standardeve apo status që lejojnë njohjen e NS-ve që mund të marrin përfitime, si

prioritet në prokurimin publik, reduktimin e taksave, sigurimin social dhe ndihmën financiare.

- nxitjet e taksave për NS-të lejojnë uljen e kostos së bërjes së biznesit për NS dhe modelin e tyre më të qëndrueshëm

Masat mbështetëse institucionale dhe platformat e rrjetëzimit për ndërmarrjet sociale

- Këshillat,
- Agjencitë mbështetëse;
- Njësi institucionale dhe vënia në funksion të regjistrimit zyrtar të ndërmarrjeve sociale.

Disa vende kanë platforma kombëtare të rrjetëzimit që lejojnë ndërmarrjet sociale të advokojnë më shumë për interesat e tyre dhe të lehtësojnë zbatimin e masave të politikave kombëtare mbi sipërmarrjen sociale

Masat për mbështetje financiare ofrimin e shërbimeve përfshijnë:

- Kreditë koncesionale (Financa sociale) ndihmojnë në ndjekjen e menaxhimit të qëndrueshëm financiar të shërbimeve sociale nëpërmjet investimeve të rikuperueshme.
- Grantet, grantet e kthyeshme dhe grantet e përputhshme mund të mbështesin SE-të, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit.
- Fondet e Garancisë lehtësojnë financimin e NS dhe stimulojnë transaksionin e shëndetshëm të kredisë duke rritur garancitë e kredive (shpesh të mbështetura nga qeveria) për detyrimet e NS premtuese, të cilat nuk kanë kolateral të prekshëm.

Masat e lidhura me edukimin

Këto masa duhet të fokusohen në nxitjen e sipërmarrjes sociale në të gjitha nivelet e arsimit, duke mbështetur (si financiarisht ashtu edhe jo-financiarisht) programe arsimore dhe projekte të të mësuatit gjatë gjithë jetës dhe duke publikuar botime informative që

promovojnë sipërmarrjen sociale; programeve edukative inovative; dhe inkurajimin e edukimit të mëtejshëm në sipërmarrjen sociale për mësuesit, të rriturit, shërbimi publik dhe sipërmarrësit socialë. Aktivitetet arsimore, nëpërmjet programeve formale dhe joformale të arsimit në nivele të ndryshme të arsimit, si dhe trajnimet, dhe transferimi i njohurive dhe aftësive, si dhe aktivitetet kërkimore mund të konsiderohen si masa mbështetëse.

Promovimi i një kulture të sipërmarrjes sociale

Promovon ekonominë sociale në mesin e të rinjve nëpërmjet tre kanaleve:

- Së pari, përmes sistemit arsimor;
- Së dyti, nëpërmjet iniciativave për të rinjtë në ekonominë sociale; dhe
- Së treti, përmes integritit të të rinjve në ndërmarrjet e ekonomisë sociale.

NS kërkojnë mbështetje nga biznesi dhe përfitojnë nga strategjitë dhe strukturat e integruara mbështetëse

Zhvillimi i kapaciteteve gjithashtu mund të ndihmojë në ndërtimin e vazhdimësisë të NS-ve të reja dhe rritjen e kapacitetit të NS tashmë të operimit në tregun e ofrimit të shërbimeve

Masa për të promovuar Sipërmarrjen Sociale

Bashkëpunimi i qeverisë me NE mund të stimulojë kërkesën për NS nga përfituesit.

Rritja e vizibilitetit të NS-ve, duke informuar mediat dhe publikun për rëndësinë e tyre; prodhimin e materialeve promovuese dhe nxjerrjen në pah të shembujve të praktikës së mirë; nxitja e promovimit të përbashkët të NS-ve dhe produkteve të tyre në treg;

“Raport mbi Vlerësimin e potencialeve në vend për zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale në Shqipëri”

Projekti ka publikuar një Raport të përgatitur pas një studimi në terren mbi situatën e ndërmarrjeve sociale në sektorin e OSHC-ve, duke synuar identifikimin e fushave të mundshme për të zhvilluar ndërmarrjet sociale, si dhe nevojat dhe kapacitetet e OSHC-ve për të menaxhuar ndërmarrjet sociale, identifikimin e praktikave të mira, të cilat mund të ndihmojnë në hartimin e veprimeve të duhura për të ndihmuar zhvillimin e sektorit.



IPA Civil Society Facility and Media Programme 2016- 2017
Support to Civil Society Organizations capacities
Reference: EuropeAid/138384/NDI/ACTUAL

Project Title: “Support the Civil Society Organizations to develop Social Enterprises in Albania”
Contract Number 2018/396114

REPORT

on

“ASSESSMENT OF POTENTIALITIES FOR DEVELOPMENT SOCIAL ENTERPRISES IN ALBANIA”

March 2019

This publication was produced with the financial support of the European Union. Its contents are the sole responsibility of Centre for Competitiveness Promotion and does not necessarily reflect the views of the European Union

Metodologjia e anketës u bazua në një analizë cilësore dhe sasiore, duke mbledhur të dhëna parësore nga të paktën 16 qytete të ndryshme të Shqipërisë. U realizuan tetëdhjetë (80) intervista, si dhe disa diskutime në fokus grupe me organizatat nga qarqet e Shkodrës, Fierit, Vlorës dhe Tiranës. Po ashtu takimet e drejtpërdrejta dhe konsultimet kanë shërbyer gjithashtu për mbledhjen e informacioneve dhe formulimin e rekomandimeve.

Raporti hedh dritë mbi situatën e sektorit të OSHC-ve në Shqipëri në lidhje me formën ligjore dhe si e perceptojnë zbatimin në praktikë të ligjit organizatat që kërkojnë të zhvillohen në drejtim të Ndërmarrjeve Sociale. Raporti jep informacion mbi madhësinë, format e organizatave dhe të ardhurat e fituara çdo vit dhe tendencat e sektorit.

Rezultatet tregojnë se sektori është relativisht i vogël në numër, me një mesatare prej 2-4 punonjës, me kohë të plotë dhe të ardhurat e tyre mund të shkojnë nga 20-50 mijë Euro.

Gjithsesi ka një optimizëm të lartë për perspektivën e zhvillimit të sektorit, për rritjen e numrit të të punësuarve dhe diversifikimin e shërbimeve.

Më poshtë jepen rekomandimet e nxjerra në këtë raport vetëm përsa i përket çështjeve ligjore të ngritura nga organizatat gjatë procesit të studimit dhe analizës së kuadrit ligjor. Rekomandimet e tjera do të jepen në buletin e ardhshëm.

Konkretisht, qeveria shqiptare ka vlerësuar përfshirjen e lartë të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në përmbushjen e objektivave të qeverisë për të adresuar çështjet sociale, të cilat prekin grupet e synuara në lidhje me mundësitë e tyre për përfshirje sociale, qasje në shërbime më të mira, kujdes shëndetësor, punësim, trajnim dhe kualifikimi barazi gjinore dhe fuqizimin ekonomik të tyre. Në këtë drejtim, Qeveria ka aprovuar kornizën ligjore për rregullimin e organizimit, funksionimit të veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale, si dhe promovimin dhe ringjalljen e OSHC-ve për krijimin e ndërmarrjeve sociale.

Kuadri ligjor i NS-ve edhe pse ekziston, ka disa paqartësi në zbatim. Ligji nuk e konsideron statusin e NE-ve si një instrument që i jep më shumë hapësirë OJF-ve tradicionale të ndryshojnë drejt NS-ve, si organizata zhvillimi që mund të mendojnë hapur dhe kreativisht, të

veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të jenë përgjegjës dhe të raportojnë për aktivitetet e tyre.

Ndonjëherë, Ligji të jep përshtypjen sikur është miratuar thjesht për të krijuar një bazë ligjore për të rregulluar Fondin e Ndërmarrjeve Sociale përmes një skeme të ndihmës shtetërore për NS.

Prandaj, qeveria duhet të konsiderojë "Statusin e Ndërmarrjeve Sociale" si një njohje nga komuniteti, pushteti lokal, autoriteti tatimor, etj. për OJF-të që kryejnë veprimtari ekonomike brenda statusit jofitimprurësve dhe jo vetëm si një instrument për organizatat jofitimprurëse për të përfutur fonde publike.


Ligji nuk parashikon një organizatë me statusin e NS për ta lëshuar statusin dhe për të vazhduar funksionimin si OJF, por e konsiderojnë atë si një strukturë unike që duhet të likuidohet dhe të shpërndajë pasurinë në rast të dështimit.

Prandaj, rekomandohet që NS të njihen si struktura hibride të funksionimit, të financuara nga grante dhe nga aktiviteti ekonomik, dhe ligji të vendoset vetëm për pjesën ekonomike të të ardhurave të krijuara. Ndarja e veprimtarisë ekonomike me një NIPT sekondar do të ishte mundësia për të zgjidhur disa prej paqartësive.

Gjithashtu, rekomandohet që Ministria e Shëndetësisë, në rolin e saj udhëheqës për nxjerrjen dhe zbatimin e këtij Ligji duhet të vendosë në tryezë diskutimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të zgjidhur çështjet praktike të ngritura në lidhje me funksionimin e NS-ve, në lidhje me problemet e NIPT-it, gjobitjet, falimentimet, pagat e vendosura tavan pa ndonjë referencë, udhëzimet drejtuar organit tatimor për të njohur këto forma të organizimit, etj, të cilat në fakt janë çështje të ndërlikuara për OJF-të, që kërkojnë orientim të drejtë.

TE DHENA MBI GRANTET E SHPERNDARJA SIPAS SEKTOREVE DHE RAJONEVE

SHPERNDARJA E GRANTEVE SIPAS SEKTOREVE NR=30




Shpërndarja e granteve për organizatat e shoqërisë civile nga projekti sipas sektorëve të ndryshëm që përfshihen në VKM-në për fushat e veprimtarisë së Ndërmarrjeve Sociale, rezultojnë se në përqindje më të madhe ato veprojnë në **sektorin e prodhimeve artizanale prej leshi**, veçanërisht ato që ruajnë traditën e punimit të leshit dhe **kostumeve popullore**, si pjesë e trashëgimisë kulturore, **qëndistari**, etj.

Gjithashtu në përqindje më të madhe janë edhe **prodhimet me karakter tradicional dhe lokal** si në zonat e Pukës, Pogradecit apo edhe sapuni i grave të Roskovecit.

Kultura dhe agroturizmi dhe shërbime të bare dhe katering janë gjithashtu interesante për tu zhvilluar si NS, duke angazhuar në punë persona që vijnë nga shtresat më të pafavorizuara.

Sektorët e **bujqësisë, të shërbimeve të pastrimit në shtëpi**, apo ndërtesa publike dhe private, **riklimi dhe përdorimi i drurit** në zëvendësim të plastikës janë identifikuar si me interes në këtë drejtim

Të rëndësishme janë edhe **shërbimet e lidhura me kujdesin shëndetësor** të njerëzve me probleme në shëndetin e artikullimit fizik apo edhe kontribute për shërbime të fëmijëve me çrregjullime të spektit autik.



ORGANIZATAT ZBATUESE TË PROJEKTIT



Adresa: Rr. "Durrësit" P.7/1/1,
Tiranë -ALBANIA
E-mail: info@ccp.al;
Tel +355 692141920;
Web: www.ccp.al,

www.facebook.com/ccpalbania
Person Kontakti: Alida Kondi



Adresa: Rruga "Ismail Qemali" P 34/1,
Ap3, Tirane
Tel & Fax: [04 254603](tel:04254603)/ [04 235704](tel:04235704),
e-mail: ilirda@albmail.com
Person Kontakti: Ilir Rembeci

Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP) është një organizatë jo-fitimprurëse, që ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2011. Ajo ka fokusin kryesor në drejtim të ofrimit të mbështetjes për biznesin dhe zhvillimin e sipërmarrjes, nxitjen e start-up dhe zhvillimin e ekonomisë sociale. Organizata ka eksperiencë në menaxhimin e projekteve. Ajo ka eksperiencë të gjërë duke punuar me aktorët e biznesit, institucionet publike dhe donatorët në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin, trajnime për kompanitë dhe të rinjtë sipërmarrës, kërkime tregu, studime dhe raporte dhe veprimtari promovuese.

Agjencia Rajonale e Zhvillimit (ARZH) u themelua në vitin 1998. Misioni i saj kryesor është mbështetja e zhvillimit të sektorit të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Me mbi 20 vite pervojë, ARZH ka përmbushur detyra të rëndësishme duke kontribuar me punë pranë komunitetit lokal të biznesit, kontribuesve ndërkombëtare, autoriteteve qendrore e lokale si dhe OJQ-ve për të përmirësuar klimën e biznesit dhe inkurajuar zhvillim ekonomik në rajon nëpërmjet implementimit të programeve të përbashkëta koordinuese, si dhe ka shërbyer si një qendër resursesh kros-sektoriale. Organizata ofron trajnime, studime tregu, planifikime biznesi, nxitje të sipërmarrjes dhe menaxhime projektsh.